



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universiteti Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Prisuar rreth	do 04. 2023
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-230

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren - Kosovë; Tel: +383 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. ref. _____

Data _____ / _____ / _____

Në bazë të nenit 19 pika 1 të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, nenit 27 pika 2 e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" nr. 04-V-621, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më 19.04.2023, mori vendim për të shpall:

KONKURS

për zgjedhjen e rektorit të Universitetit "Ukshin Hoti"

I. Kushtet për aplikim:

- Konkurrimi për postin e Rektorit është i hapur për kandidatët e brendshëm dhe të jashtëm;
- Kandidati duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:
 - të ketë përvojë të dëshmuar në mësimdhënie akademike, kërkime shkencore dhe të ketë gradën më së paku të profesorit të asocuar.
 - të ketë përvojë të dëshmuara menaxhuese universitare;
- Të mos ketë qenë në pozita udhëheqëse në ndonjë parti politike apo në listë zgjedhore të ndonjë partie politike ose koalicioni në nivel qendror dhe lokal në tri (3) vitet e fundit.

II. Dokumentet për aplikim¹:

- Kërkesën për shprehje interesi;
- Deklaratën nën betim;
- Biografinë e shkurtër;
- Ekstraktin e lindjes, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën penale;
- Vendimin mbi thirrjen akademike, certifikatën apo ekuivalente;
- Kopjet e diplomave apo dëshminë mbi përfundimin e studimeve pasuniversitare (për studimet jashtë vendit edhe vendimin mbi nostrifikimin e diplomës).
- Dëshminë mbi përvojën akademike (në mësimdhënie, kërkime shkencore, krijimtari artistike) dhe menaxheriale në arsimin e lartë;
- Vizionin mbi menaxhimin e universitetit.

III. Forma e aplikimit dhe mënyra e zgjedhjes:

Zgjedhja e rektorit bëhet në bazë të dispozitave të nenit 26, 27 të Statutit të Universitetit. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë kandidatët pa asnjë lloj diskriminimi, të cilët i plotësojnë kriteret ligjore të parapara për këtë pozitë.

Dokumentet e kompletuara në kopje fizike dorëzohen çdo ditë pune, sa është i hapur Konkursi prej orës 8:00 - 16:00 në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Zyra nr. 526, Administrata Qendrore; Adresa: "Rruga e Shkronjave", p.n. 20000, Prizren - Republika e Kosovës.

Aplikacioni i drejtohet Komisionit Profesional, të formuar nga Senati i Universitetit. Të gjitha dokumentet përveç në kopje fizike, dërgohen edhe në formë elektronike (të skanuara) në adresën: apliko.upz@uni-prizren.com. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në faqen zyrtare të Universitetit, përkatësisht nga deri më 05.05.2023.

¹ Dokumentacioni mbi gjendjen civile si dhe dëshmia nga gjykata mund të sigurohet edhe përmes platformës: ekosova.rks-gov.net, ndërsa dokumentacioni mbi thirrjen akademike dhe diplomën Universitare kërkohet të jetë origjinale ose e noterizuar.